

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gyltene Sylejmani kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit R. M. nga Malisheva, të cilin e përfaqëson B. K. avokat nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë, e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal Mujë Sahitaj, për anulimin e aktvendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimin në vendin e punës si dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC nr 2645/2015 datë 25.4.2016, në seancën e mbajtur me datën 2.11.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC .nr 2645/2015 datë 25.4.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2645/2015 datë 25.4.2016, refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë, dhe vërtetohet aktgjykim i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, C .nr. 140/2014 datë 10.6.2015, me të cilinë është aprovuar në tërësi kërkesëpapia e paditësit R. M. nga Malisheva si e bazuar. Në paragrafin I të dispozitivit, anulohet aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 11/ 983 i datës 4.11.2014 . Në paragrafin II të dispozitivit, detyrohet e paditura Komuna e Malishevës, që paditësin ta kthejë në

vendin e punës sipas kontratës arsimtar në SHFMU “ Ibrahim Mazreku “ në Malishevë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe t’ia kompensojë të ardhurat personale dhe atë për muajin shkurt, mars, prill të vitit 2004 nga 205 €, ndërsa për muajt tjerë nga 410 €, deri sa paditësi të kthehet në punë dhe detyra të punës që i ka ushtruar më parë. Me të njëjtin aktgjykim, në paragrafin III të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj dhe atë : për hartimin e padisë shumë prej 80 € si dhe për dy seanca gjyqësore 270.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion me kohë ka paraqitur e paditura për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i të dy gjykatave të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit apo të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK- së, ka gjetur se;

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas kontratës së punës me nr. 11/208 të datës 23.10.2013, paditësi me të paditurën përkatësisht DKAE në Malishevë ka lidhë kontrata të punës me kohë të caktuar prej datës 2.9.2013 deri me datën 31.8.2014, se është i licencuar si mësimdhënës me licencë me nr. ..., me afat të skadimit Paditësi është suspenduar nga puna me aktvendimin e të paditurës nr. ..., të datës ... , me pagesë nga data 1.11.2013, me arsyetim se ndaj tij janë duke u zhvilluar hetime për veprën penale nga neni 239 i KPK-së. Me aktvendimin nr. ..., të datës 4.11.2014 paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me arsyetim se që nga suspendimi me pagesë, të paditurës nuk i ka ofruar dëshmi për rastin e ti. Paditësi është ankuar në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë ,ndërsa nga paditësi dhe e paditura nuk është ofruar prova se është dhënë ndonjë përgjigje nga Inspektorati. Ndaj paditësit është ngritur aktakuza për veprën penale, të paraparë me dispozitën e nenit 232 të KPRK-së. Sipas aktakuzës Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin, P.nr. 373/ 2013 datë 11.9.2017, paditësi është shpallur fajtor dhe është dënuar me burg në kohëzgjatje prej 9 muajve. Sipas ankesë së paditësit në Gjykatën e

Apelit, është marrë aktgjykimi PAKR. nr. 569/14 i datës 24.12.2014, ku paditësi është liruar nga akuza dhe është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë .

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se ndërprerje e marrëdhënies së punë së paditësit është ndërprerë në kundërshtim me dispozitën e nenit 67 par . 1 pika 6 të Ligjit të Punës. Edhe përkundër faktit se paditësi ka pasur kontrata të punës me kohë të caktuar, sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për arsimtar sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitarë dhe Udhëzimit Administrativ 09/2014 neni 3 dhe 4 dhe bazuar në nenin 7,8, dhe 143 të LPK ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit ka pranuar si të drejtë qëndrimin juridik dhe konstatimin fakti të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ankesën e të paditurës e ka refuzuar si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë. Faktet të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë nuk vihen në pyetje në thëniet në revizion, provat tjera të analizuarra më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë e materializojnë konstatimin e saj të fundit lidhur me zbatimin e së drejtës materiale me rastin e refuzimit të ankesës së të paditurit. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat shkelje kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje në të cilat revizioni pretendon.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i atakuar është rrjedhë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se, paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në pajtim me nenin 70,73 dhe 75 të Ligjit të Punës së paditësit, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme dhe si të tilla janë refuzuar për faktin se, sipas mendimit të kësaj Gjykate aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit është marrë në kundërshtim me nenin 67 par 1 pika 6 të Ligjit të Punës nr. 03/L-2012, që i referohet ndërprerjes së marrëdhënies

së punës sipas fuqisë ligjore nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili nuk do të zgjatë më tepër se (6) gjashtë muaj. Në rastin konkret paditësi nuk ka shkuar në vuajtje të dënimit, pasi që me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, është marrë aktgjykimi PAKR. nr. 569/14 i datës 24.12.2014, ku paditësi, është liruar nga akuza dhe në këtë situatë të krijuar dispozita e nenit 75 e Ligjit të Punës, nuk mund të gjen zbatim ashtu si pa bazë theksohet në revizion, kjo për faktin se, në momentin kur paditësi është liruar nga aktakuza, e cila ka qenë arsye edhe e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e paditura ka pasur për obligim që paditësin ta kthejë në marrëdhënie pune.

Parashtrimet në revizion se kthimi i paditësit në marrëdhënie pune dhe njohja e të drejtës në kompensimit e të ardhurave personale nuk ka mbështetje ligjore për faktin se paditësi ka pasur marrëdhënien e punës me kohë të caktuar dhe gjatë asaj kohe i ka realizuar të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës , janë pretendime të pabazuara dhe si të tilla u refuzuan për faktin se, ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit nuk është bërë për shkak të skadimit të kontratës por për shkak të hetimeve të zhvilluara ndaj tij. Po ashtu, kthimi i paditësit në marrëdhënie pune ka mbështetje ligjore edhe në dispozitën e nenit 3 dhe 4 të Urdhëresës Administrative nr.09/2004, ashtu si drejtë ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë.

Objekt shqyrtimi ishin edhe parashtrimet se paditësi nuk gëzon të drejtën në mbrojtje gjyqësore, për arsye se nuk i ka ndjekur procedurat administrative, për mbrojtjen e të drejtës nga marrëdhënia e punës, parashtrime e tilla nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave në lëndë dhe si të tilla u refuzuan sepse nga shkresat në lëndë del se paditësi duke vepruar sipas udhëzimit juridik në aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ka ushtruar ankesë në Inspektoratin e Arsimit në Gjakovë me datë 10.11.2014 por përgjigje nuk ka marrë.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.204/2016 datë 2.11.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani